

# NJOFTIM PËR PUBLIKUN

**Shkup, 18 maj 2022** – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dënon thirrjen e gazetares „Dua të them“ në bisedë zyrtare policore për teksin e shpallur dhe theksoi se veprime të tilla kërcënojnë lirinë e medias .

Apsolutisht është e papranueshme të thirren gazetarë në biseda informative për shkrime të shpallura me interes publik, pasi mund të interpretohen si një përpjekje për frikësim, e cila nga ana tjetër kontribuon në shfaqjen e autocensurës. Raste të tilla kanë ndikim negativ në lirinë e informimit.

Agjencia përkujton se kushdo që mendon se medium i caktuar i ka shkelur reputacionin dhe nderin duke shpallur të pavërteta, të paverifikuar ose informacione të pasakta, ka të drejtën të kërkojë nga media të shpallë demant, përgjigje dhe korigjim, ose të dërgojnë parashtresë drejtuar organeve vetërregullatore për mediat.